




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## INFORMATA TË PËRGJITHSHME

### Parashtrimi i kërkesave në proces të Likuidimit



**Për informata më të  
hollësishme ju lutem drejtohuni në  
zyret e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**

Zyra Qendrore e AKP-së  
Rr. Dritan Hoxha, Nr. 55, Lakrishtë,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## Agjencia Kosovare e Privatizimit

Zyra Qendrore e AKP-së

Rruga "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë,  
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

T: +383 (0) 38 500 400

E: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

## Informata relevante

Procesi i likuidimit konsiderohet si i filluar që nga data e vendimit mbi fillimin e procedurave të likuidimit të përcaktuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve.

Sipas vendimit të Bordit përcaktohet që Menaxhmenti autorizohet të bëj emërimin e Anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit si dhe të bëj zëvendësimin e kohëpaskohshëm të tyre.

Brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e Vendimit për Likuidim, Agjencia do të publikoj Njoftimin për Likuidim.

Sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059 të datës 15 tetor 2020, AKP udhëzohet që së pari të bëj një spot informues, me qëllim të informimit të palëve të interesit se të gjitha informatat në lidhje me publikimin e njoftimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, nuk do të publikohen më në gazetatat e shkruara, por tani e tutje publikimi i njoftimeve do të bëhet vetëm në mediat televizive dhe në ato elektronike. Spoti informues do të transmetohet në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe si dhe në portalet online, për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje minimale prej 30 sec me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 - 21:00.

Njoftimi ndër të tjera përmban edhe afatin kohor për parashtrim të kërkesës kreditore ndaj Ndërmarrjes.

Njëkohësisht, përmes postës, njoftohen edhe kreditorët e njohur, të cilët udhëzohen që të veprojnë sipas Njoftimit të publikuar.

### 1. Kërkesat Kreditore

- a) kërkesat e siguruara;
- b) kërkesat pronësore ndaj aseteve specifike;
- c) kërkesat për paga të papaguara (tre pagat e fundit para vendosjes në likuidim);
- d) kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës;
- e) kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë;
- f) kërkesat e pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve apo partnerëve në ndërmarrje.

Hapat në vazhdim që duhet të ndërmerren për të paraqitur kërkesën kreditore:

- Të shkarkoni formularin relevant për parashtrimin e kërkesës nga uebfaqja e Agjencisë në [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org) dhe ta plotësoni atë;
- Të bashkangjitni dokumentet mbështetëse mbi të cilat bazohet kërkesa juaj, dhe
- Formulari i plotësuar së bashku me dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohet në zyrën rajonale përkatëse të Agjencisë.

Duhet pasur parasysh se afatet ligjore duhet respektuar në të kundërtën kërkesa juaj nuk do të merret parasysh. Prandaj, pas datës së publikimit të njoftimit për likuidim ju duhet që brenda 45 ditëve të dorëzoni kërkesën tuaj.

### 2. Kërkesat pas afatit

Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave.

Pas skadimit të afatit, Autoriteti i Likuidimit brenda 60 ditëve vlerëson vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e kërkesës suaj. Lidhur me vendimet e marra ju do të njoftoheni me kohë.

#### ***Këshilla Juridike:***

***Në rast se nuk jeni të kënaqur me vendimin e marrë nga Autoriteti i Likuidimit ju mund të parashtroni ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.***